



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC

Kodi: 027

Strategjitë për krijimin e mendimtarëve kritik

Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- Të krijojnë klasa që nxisin bashkëveprim të hapur dhe të përgjegjshëm.
- Të përdorin një strukturë për mësimdhënien që nxit mendimin kritik dhe të nxënësit e pavarur.
- Të përdorin teknika të shumëllojshme e të efektshme, të cilat ndihmojnë nxënësit në procesin e përvetësimit të njohurive dhe kontrollimit të tyre.
- Të bëhen burim përvojë dhe njohurish për mësimdhënësit e tjerë.

Me zbatimin e këtij Programi nxënësit aftësohen:

- Të mendojnë në mënyrë kritike. Pra, nxënësit duhet përgatitur që të jenë kureshtarë dhe të përdorin strategjitë e kërkimit dhe shqyrtimit të pavarur, të bëjnë pyetje dhe në mënyrë sistematike të kërkojnë përgjigjet e tyre.
- Të marrin përgjegjësinë për të nxënësit e tyre. Nxënësit nuk do t'i përvetësojnë njohuritë e dhëna nga mësimdhënësi në mënyrë pasive, por do të përdorin strategjitë e shqyrtimit përmes procesit të të lexuarit, shkruarit dhe diskutimit për të nxënë vetë. Nxënësit duhet të dijnë të bëjnë sistemimin e informacionit dhe të vënë në përdorim shprehitë e studimit të pavarur.
- Të punojnë bashkë me të tjerët. Nxënësit duhet të aftësohen për të dëgjuar të tjerët me kujdes dhe respekt, të flasin me mirësjellje dhe të kenë besim te të tjerët, të përdorin strategjitë për identifikimin e problemeve, të kontribuojnë për gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta duke vepruar si anëtarë të përgjegjshëm të grupit.
- Të bëhen qytetarë që mësojnë gjatë gjithë jetës. Nxënësit duhet të përvetësojnë strategjitë e kërkimit, me qëllim që të jenë në gjendje t'i përdorin ato edhe për shumë vite pas përfundimit të shkollimit.

Përmbajtja

1. Seminari për të shkruarit “Nga të vetëshprehurit tek argumentet e shkruara”. – Procesi i të shkruarit: Përgatitja, Hartimi, Rishqyrtimi, Redaktimi dhe korrektimi, si dhe Botimi. Teknikat: Karriga e autorit, RAFT, Imagjinata e drejtuar, Esetë argumentuese etj. Shyrtimi i teknikave nga ana përmbajtësore dhe proceduriale. Diskutimi për zbatimin e këtyre teknikave në klasë.

2. Krijimi i lexuesve mendimtarë.– Katër përbërësit e seminarit të lexuesve: Minileksioni, Leximi, Bashkëbisedimi dhe Përgjigjet. Seminari i lexuesve dhe kuadri i të nxënit ndërveprues. Teknika: Pyetje drejtuar autorit. Shembuj formularësh kontrolli.

Grupi i synuar

Nga ky program mund të përfitojnë mësime të cilët kanë përfunduar trajnimin “Strategjitë e reja të mësimit dhe të nxënimit”.

Forma e organizimit/ Kohëzgjatja

Programi organizohet në formë të 2 seminareve 2-ditore, të cilat zhvillohen gjatë një muaji. Çdo seminar ka 16 orë trajnim.

Programi ka gjithsej **32 orë**.

Certifikimi

Pjesëmarrësit do të certifikohen për pjesëmarrje. Kusht për certifikimin është përcjellja me rregull e seminareve mbi 80 %.

